

Nr. 9297 prot
dt. 14.09.2021

Shkresë së Informacionit



AB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Nr.19/45 Akti

Tiranë, më 13.09.2021

Lënda: Kërkesë për afishimin e njoftimit me shpallje publike.

Drejtuar: Bashkisë Delvinë ✓
Bashkisë Tiranë.

Bashkëngjitur ju dërgojmë kopje të shkresës me nr.19/45 Akti, datë 13.09.2021
për afishim të njoftimit me shpallje në këndin e Institucionit tuaj.

GJYQTAR
ERJON ÇELA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Nr.19/45 Akti

Tiranë, më 13.09.2021

Njoftim me shpallje

Në datë **27.09.2021, ditë e hënë, ora 10:00** në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është caktuar për t'u zhvilluar seanca gjyqësore në ngarkim të të pandehurëve: **1.Dritan Gramozi**, akuzuar Për kryerjen e veprave penale të "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave", "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve", "Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal" parashikuar nga nenet 189/2, 190/2, 298/2, 28/4, 333/a/1 dhe 334/1 të Kodit Penal. **2.Arjan Shehu**, akuzuar për kryerjen e veprave penale të "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve", "Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 298/2, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

Gjykata konform nenit 140/5 të K.Pr.Penale, vendosi të njoftojë me shpallje në vendin e banimit, të pandehurit:

1.Dritan Gramozi, i biri i Janaq dhe i Spira, i datëlindjes 17.09.1974, lindur dhe banues në **Stjar, Delvinë**.

2.Arjan Shehu, i biri i Sefer dhe i Ëngjëllushe, i datëlindjes 30.03.1973, lindur në Toç, Tepelenë dhe banues në **Tiranë**, për t'u paraqitur pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, më datë **27.09.2021, ditë e hënë, ora 10:00**.

Mosparaqitja e të pandehurve të sipërcituar, në seancën e ardhshme, shkakton gjykim në mungesë.

Një kopje e kësaj shpallje të afishohet në këndin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, një kopje i dërgohet për afishim **Bashkisë Delvinë, Bashkisë Tiranë, Zyrrave postare Tiranë dhe Delvinë** për të afishuar shpalljen në banesën e të pandehurve, dhe një kopje qëndron në dosje.

Gjykata urdhëron depozitimin e shkresës për realizimin e afishimit të njoftimit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda seancës së ardhshme.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin,

GJYQTAR
ERJON CELA